



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-
Ministry of Culture, Youth & Sports

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge
Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage
Prizren

DATË/A:	23.06.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 128/4
PËR/ZA/TO:	Drejtorja për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Samir Hoxha - Drejtor i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendimi i Komisionit të IKMM-së Prishtinë

Po ju dërgojmë Vendimin e Komisionit të IKMM-së për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese-Konservuese të Trashëgimisë Kulturore nr.46/2017 të dt. 08.06.2017 për lëndën Haxhi Muharem Nr.04-353/01-33325 për mbindërtimin e nënkulmit të shtëpisë individuale për banim në ngastrën kadastrale Nr. 01899-1.

Lëndës ia bashkangjesim kopjen e Vendimit.

23.06.2017
[Signature]
Arben Shkëti
Kryetar për Zonë Bellësi



NR. 314 / 22.06.2017
PRISHTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve
Kosovo Institute for the Protection of Monuments
Institut Kosova za zaštitu spomenika

Nr. 46/2017
Datë: 08.06.2017

U.D. Drejtori i Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve z. Agim Gërguri duke u mbështetur në nenin 3 (paragrafi, 4, 8), nenin 4 (paragrafët 14, 17, 19 dhe 20) nenin 6 (paragrafët 3, 4, 5, 7 dhe 8), nenin 12 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 02/L – 88 për Trashëgiminë Kulturore, si dhe në zbatim të vendimit Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sportit Nr. 18/2016 të datës 04.03.2016, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet rekomandimi i Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore të Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve: “Miratimi i Projektit për ndërtimin e nënkulmit në shtëpinë ekzistuese në ngastrën kadastrale Nr. 1899 – 1, Z. K. Prizren”.
2. Në bazë të rekomandimit të Komisionit, kërkohet që gjatë zbatimit, të respektohet projekti zbatues, i cili duhet të dorëzohet dhe miratohet në komision.
3. Zbatimi i punimeve sipas Projektit të aprovuar bëhet nën mbikëqyrjen e një eksperti nga Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore –Prizren.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Haxhi Muharremi nga Prizreni ka parashtruar kërkesë për mbindërtimin e nënkulmit në ngastrën kadastrale me nr. 1899-1. Objekti ekzistues gjendet në lagjen e Marashit, në Zonën e VI-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike, ku etazhiteti i lejuar është dy deri tri kate (lartësia maksimale deri te streha është 9.5m) dhe për ndërtim mund të shfrytëzohet 60% e sipërfaqës së parcelës. Në afërsi të parcelës ku do të mbindërtohet objekti gjenden monumente si Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe Xhamia e Maksut Pashës, që janë në Listën e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të Përkohshme (10.10.2016 – 10.10.2017). Objekti është në rrugën “Vatrat Shqiptare” Nr. 48.

Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, pas shqyrtimit të lëndës, ka rekomanduar si më poshtë:

1. Aprovohet kërkesa e Haxhi Muharremi për ndërtimin e nënkulmit në shtëpinë ekzistuese, në ngastrën kadastrale 1899-1, në lagjen e Marashit në Prizren, e cila është në pajtim me kriteret e përcaktuara për Zonën e IV-të sipas Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit.
2. Njoftohet pala se Projektin Kryesor, të Projektit Ideor të miratuar nga Komisioni për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese – Konservuese të Trashëgimisë Kulturore / IKMM, duhet ta dorëzojë në QRTK – Prizren për verifikim (të gjitha kopjet e projektit që i nevojiten palës). Dy kopje dixhitale dhe dy kopje fizike të projektit kryesor mbeten në QRTK – Prizren (një për QRTK – në dhe një për IKMM – në).

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komisionit për Shqyrtimin e Kërkesave dhe Projekteve IKMM;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- QRTK – së përkatëse;
- Komunës përkatëse;
- Departamentit Ligjor – MKRS;
- Zyrës së Drejtorit të IKMM –së;
- Arkivit të IKMM –së;
- Arkivit të MKRS – së;

